

V E N D I M
Nr.190, datë 3.5.1995

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874, DATË 17.11.1994 “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË”

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për organizimin dhe drejtimin e punës për dhënien e statusit të veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë, në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet “Departamenti i veteranëve dhe invalidëve të luftës e të ushtrisë”.

2. Komisionet e rretheve do të funksionojnë pranë degëve ushtarake dhe kanë në përbërje kryetarët e degëve ushtarake, të cilët kryesojnë mbledhjet e komisioneve dhe nga një përfaqësues nga bashkia, këshilli i rrethit, dega e brendshme, sigurimet shoqërore, një jurist, dy veteranë, si dhe një invalid të luftës kundër pushtuesve nazifashistë.

3. Komisioni qendror pranë Ministrisë së Mbrojtjes kryesohet nga nënministri i Mbrojtjes dhe në të bëjnë pjesë: drejtori i departamentit të veteranëve dhe invalidëve të luftës e të ushtrisë, një jurist në Ministrinë e Mbrojtjes, drejtori i arkivit të ushtrisë, një specialist nga Drejtoria e Arkivave të Shtetit, një përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Ish-të Përndjekurve Politikë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe dy veteranë e një invalid të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë.

Komisioni Qendror, pasi shqyrton materialet e paraqitura nga komisionet e rretheve, vendos, sipas rastit, për dhënien ose jo të statusit të veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë.

4. Përbërja emërore e komisioneve në rrethe të caktohet nga ministri i Mbrojtjes. Për hartimin e listave të komisioneve Ministria e Mbrojtjes mbështetet në propozimet e pushtetit në rreth dhe të organizatave të veteranëve.

5. Për qënien veteran i luftës, në kuptimin e shkronjës “d” të nenit 3 të ligjit, për raste të veçanta do ta konsiderohen edhe dëshmi individuale për veteranët, të cilëve nuk u është njohur kjo e drejtë nga regjimi totalitar për shkaqe politike e biografike.

6. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë nuk do ta përfitojnë personat që janë dënuar për krime të rënda kundër lirisë e pavarësisë, të cilët nuk kanë përfituar nga ligji mbi fajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë.

7. Shpërblimi i veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë jepet mbi pensionin e pleqërisë dhe kompesimet e tjera që mund të marrin, në masën e caktuar si vijon:

a) 1500 lekë për veteranët që luftuan në formacione luftarake të çdo rangu kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar përpara datës 10.7.1943;

b) 1200 lekë për veteranët që luftuan në formacione luftarake të çdo rangu kundër pushtuesve nazifashistë, të inkuadruar në këto informacione në periudhën 11.7.1943 deri në 24.5.1944;

c) 1000 lekë për veteranët që luftuan në formacione luftarake të çdo rangu, të inkuadruar në këto informacione në periudhën 25.5.1944 deri në 28.11.1944;

d) 500 lekë për veteranët që kanë zhvilluar veprimtari të organizuar në ilegalitet në prapavijë të armikut e në zona të çliruara, për kryefamiljarët e atëhershëm të familjeve që njihen si bazë e luftës kundër pushtuesve nazifashistë;

e) 300 lekë për veteranët e inkuadruar në formacionet luftarake pas datës 28.11.1944 dhe që vazhduan luftën jashtë kufirit të atdheut; shumën prej 300 lekësh e përfitojnë (mbi masën e caktuar) edhe veteranët e përfshirë në shronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike të vendimit, kur kanë vazhduar luftën jashtë kufijve të atdheut të inkuadruar në formacionet luftarake.

8. Të burgosurit në burgjet nazifashiste brenda dhe jashtë vendit, për kohën e burgosjes mbi gjashtë muaj, marrin shpërblim sipas shkronjës “d” të pikës 7, kurse për kohën e burgosjes nga një deri në gjashtë muaj marrin shpërblim sipas shkronjës “e” të pikës 7 të këtij vendimi.

9. Të internuarit në kampet e përqendrimit nazifashistë të shfarosjes në masë, përveç

shpërblimit të veteranit të shkronjës “a”, pika 7, kur nuk kanë përfituar nga statusi i invalidit të luftës, marrin edhe shpërblimin e invalidit të luftës të grupit të parë.

10. Dokumentet bazë (dëshmi, lista, vërtetime) për të burgosurit dhe të internuarit në kampet e përqendrimit nga pushtuesit nazifashistë janë ato që kanë ardhur nga kampet (burgjet), Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, organizma shtetërorë të vendeve që kanë pasur kampe (burgje) të tilla, si dhe nga ambasadat shqiptare në ato shtete.

11. Veteranët e plagosur në luftë, që nuk përfitojnë statusin e invalidit të luftës, përveç shpërblimit mujor të veteranit marrin edhe një shtesë në masën 500 lekë në muaj. Këta persona përcaktohen mbi bazën e dokumenteve të lëshuara nga Drejtoria e Arkivave të Shtetit, Arkivi i Ushtrisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe komisioni mjekësor pranë spitalit qendror të ushtrisë.

12. Personat që kanë statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, përveç shpërblimit që marrin si të tillë, përfitojnë edhe shpërblimin e veteranit të luftës që u takon.

13. Familjet e veteranëve të vdekur që përfitojnë këtë status, por që nuk kanë pasë marrë shpërblimin prej 100 lekësh në muaj, u jepet një shpërblim i menjëhershëm në masën 20.000 lekë. Këtë shpërblim e përfitojnë bashkëshortët, prindërit ose fëmijët e paaftë për punë.

14. Anëtarëve të komisioneve në rrethe për statusin e veteranit të luftës që nuk janë në marrëdhënie pune, për kohën që do të punojnë, u jepet një shpërblim mujor sipas vlerësimit të Ministrisë së Mbrojtjes, por jo më shumë se 300 lekë në ditë.

15. Dokumentet për njohjen e statusit të veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë i paraqiten komisionit të rrethit individualisht. Afati përfundimtar i pranimi të dokumenteve është data 30.12.1995.

16. Listat e personave që përfitojnë statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë në masën e shpërblimit përkatës, Ministria e Mbrojtjes ia dorëzon Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

17. Shpërblimi i veteranit të luftës jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore kundrejt paraqitjes së “Librezës së veteranit” të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, lëshuar nga komisioni qendror pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

18. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të lëshojnë udhëzime në zbatim të këtij vendimi dhe të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994.

19. Veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë u jepet e drejta të pushojnë individualisht një herë në tre vjet në shtëpitë e pushimit që financohen nga shteti, kundrejt pagesës me 1/3 e çmimit, sipas organizimit që kryen departamenti në Ministrinë e Mbrojtjes.

20. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1995 i shtohen 600 milionë lekë, të parapara në buxhetin e shtetit për efektet financiare të këtij vendimi. Në këtë shumë përfshihen edhe efektet financiare për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.189, datë 6.3.1995 “Për trajtimin shëndetësor të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, si dhe 8 milionë lekë për shpenzimet administrative të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij financiare nga data 1.12.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi